

VENDIM
Nr.672, datë 27.9.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JOPUBLIKE
“WISDOM UNIVERSITY”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Wisdom University”, në emër të shoqërisë “Wisdom” sh.p.k., e cila do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Wisdom University” do të ofrojë studimin në distancë, i cili do të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin “S. PioV” të Romës, sipas marrëveshjes. Në këtë universitet do të zhvillohen studimet në degët:

- Shkenca bankare dhe të sigurimeve;
- Shkenca politike.

3. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Wisdom University” do të ofrojë studime universitare të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 (tre) vite akademike. Në mbarim të studimeve “Wisdom University” do të japë diplomë universitare “Bachelor”, në titujt:

- Shkenca bankare dhe të sigurimeve;
- Shkenca politike.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Wisdom University” do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve në distancë.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë verifikimin e plotësimit të kushteve për fillimin e procesit mësimor. Çdo ndryshim në përcaktimin e vendndodhjes, stafin pedagogjik, planeve dhe programeve, si dhe në elementet e tjera, të miratuara, të bëhet me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha